



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 108

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 1 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 57/2024, datë 6.6.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri..... 11383
Dekret i Presidentit nr. 232, datë 25.6.2024	Për shpallje ligji..... 11391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 26.6.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar”..... 11391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 422, datë 26.6.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar..... 11396



LIGJ
Nr. 57/2024

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM
DHE STATUSIN E ZYRËS SË
KOORDINIMIT TË PROGRAMEVE TË
TIKA-s NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.6.2024.

Shpallur me dekretin nr. 232, datë 25.6.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, PËR
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIM DHE
STATUSIN E ZYRËS SË KOORDINIMIT
TË PROGRAMEVE TË
TIKA-s NË SHQIPËRI

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Turqisë (në vijim të referuara si “Palët”);

bazuar në marrëdhëniet miqësore ndërmjet dy vendeve;

në kuadër të qëllimit të zhvillimit të bashkëpunimit ekonomik dhe social; si dhe

me dëshirën për të thelluar marrëdhëniet nëpërmjet bashkëpunimit për zhvillim,
kanë rënë dakord për sa më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

1. Objektivi kryesor i kësaj marrëveshjeje është të përcaktojë kuadrin ligjor dhe institucional të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet palëve.

2. Sipas kësaj marrëveshjeje, palët bashkëpunojnë me qëllim që të mundësojnë zbatimin e projekteve dhe programeve të bashkëpunimit për zhvillim, me synimin për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik në Shqipëri.

Neni 2
Zbatimi

1. Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (në vijim e referuar si “TIKA”), e cila vepron në emër të qeverisë së Turqisë, dhe Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (në vijim e referuar si “SASPAC”), e cila vepron në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, janë përgjegjëse për bashkëpunimin dhe zbatimin e projekteve dhe të programeve të zhvilluara në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

2. TIKA do të përfaqësohet në Republikën e Shqipërisë nga Zyra e Koordinimit të Programeve të TIKA-s (në vijim e referuar si “ZKP”).

3. Progresi i arritur, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të rishikohet çdo vit nëpërmjet mbledhjeve që do të realizohen në mënyrë të alternuar në Turqi dhe Shqipëri, nga Komisioni i Përbashkët (ose Komiteti i Përbashkët/Grupi i Përbashkët i Punës) që përbëhet nga zyrtarë të TIKA-s dhe SASPAC-ut.

Neni 3
Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i palëve, në kuadër të kësaj marrëveshjeje, realizohet në formën e asistencës



teknike dhe financiare. Asistenca teknike për palën shqiptare ofrohet nga TIKa në formën e transferimit të njohurive, trajnimit të stafit, aktiviteteve të konsulencës dhe ofrimit të shërbimeve, sigurimit të pajisjeve dhe materialeve, si dhe prezantimit të teknologji ve inovative, të nevojshme për zbatimin me sukses të projekteve, programeve dhe aktiviteteve. Asistenca financiare për palën shqiptare ofrohet nga TIKa në formën e granteve, për të financuar furnizimin e mallrave, pajisjeve dhe materialeve, si dhe realizimin e punëve dhe shërbimeve të nevojshme për zbatimin me sukses të projekteve, programeve dhe aktiviteteve.

2. Qeveria e Republikës së Turqisë do të zbatojë, nëpërmjet TIKa-s, projekte, programe dhe aktivitete konkrete në Shqipëri, në kuadër të kësaj marrëveshjeje. Projektet, programet dhe aktivitetet mund të kryhen tërësisht mbi baza dypalëshe ose në bashkëpunim me palë të treta, si p.sh.: donatorë të tjerë, organizata shumëpalëshe, OJQ ose institucione publike dhe private.

3. Projektet dhe programet e zhvilluara në kuadër të kësaj marrëveshjeje kontribuojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe për të qenë në përputhje me prioritetet dhe nevojat e popullit të saj. Kur është e mundur, bashkëpunimi duhet të promovojë përdorimin e burimeve vendore, ofrimin e mundësive të punësimit në nivel vendor dhe vlerësimin e burimeve njerëzore.

4. Koordinimi i projekteve të mbështetura nga TIKa, në kuadër të bashkëpunimit të parashikuar në këtë marrëveshje, do të sigurohet/kryhet në bashkëpunim nga palët nëpërmjet marrëveshjeve specifike.

Neni 4

Fushat e bashkëpunimit

Palët bashkëpunojnë në fushat në vijim:

1. Bujqësia, mbarështrimi i kafshëve, peshkimi dhe pylltaria;
2. Agroindustria dhe siguria ushqimore;
3. Uji dhe higjiena, ujitja;
4. Zhvillimi rural dhe ulja e varfërisë;
5. Promovimi i industrive dhe infrastrukturës cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse;
6. Përfshirja sociale dhe ekonomike e grave dhe grupeve të disavantazuara;

7. Arsimi dhe kërkimi shkencor;
8. Shëndeti i mirë dhe mirëqenia;
9. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale, fuqizimi i strukturës administrative në nivel vendor dhe qendror;
10. Ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe bashkëpunimi kulturor;
11. Mbrojtja mjedisore;
12. Turizmi;
13. Bashkëpunimi detar;
14. Promovimi i inovacionit dhe teknologjisë.

Neni 5

Zyra e koordinimit të programeve të TIKa-s

1. TIKa do të ngrejë një ZKP në Shqipëri. ZKP-ja do të vendoset në Tiranë dhe në varësi të nevojës, mund të ngrihen zyra vijuese në vendndodhje të tjera.

2. Në përputhje me legjislacionin përkatës të palëve, ZKP-ja do të zotërojë personalitet juridik në Shqipëri. Në përputhje me legjislacionin e Turqisë dhe të Shqipërisë, si dhe me legjislacionet përkatëse ndërkombëtare, ZKP-ja ka zotësinë juridike të:

- lidhë kontrata;
- marrë me qira, blejë dhe shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme;
- punësojë staf vendas në ZKP;
- hapë llogari bankare dhe të kryejë transaksione me para të gatshme;
- jetë palë në procedura ligjore.

4. Selia qendrore e TIKa-s përcakton numrin e mjaftueshëm të pjesëtarëve të stafit (koordinatorët e programit, asistentë koordinatorët, menaxherët e programit, trajnerët, konsulentët, ekspertët, asistentët, studiuesit, stafi teknik dhe personeli mbështetës) që do të emërohen në ZKP.

5. Autoritetet shqiptare lëshojnë, pa pagesë, viza hyrëse për ekspertët e caktuar përkohësisht në Shqipëri nga TIKa për zbatimin e projekteve, programeve dhe aktiviteteve të tjera, si dhe për personat e ftuar zyrtarisht nga ZKP-ja e TIKa-s.

Neni 6

Privilegjet dhe imunitetet

Për të garantuar zbatimin e plotë të projekteve që do të realizohen në kuadër të kësaj



marrëveshjeje, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë garanton masat në vijim, në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe procedurat e brendshme në fuqi.

1. Pjesëtarët e stafit të TIKa-s që janë emëruar në Zyrën e Koordinimit të Programeve të TIKa-s dhe zotërojnë pasaporta diplomatike, shërbimi ose të posaçme, përfitojnë nga të drejtat, privilegjet dhe imunitetet që u jepen agentëve diplomatikë në Shqipëri, në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatieke të vitit 1961.

2. Ambientet e ZKP-së, orëditë dhe pasuritë e tjera që ndodhen në to, si dhe mjetet e transportit në shërbim të ZKP-së, përfitojnë nga privilegjet dhe imunitetet e parashikuara për misionet e huaja diplomatike në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatieke të vitit 1961.

3. Të gjitha llojet e pasurive, të luajtshme ose të paluajtshme, të importuara ose të blera në vend, të lidhura me programet, projektet dhe aktivitetet e TIKa-s në Shqipëri, si dhe fondet e granteve që financojnë shërbimet dhe/ose punët, përjashtohen nga tatimet, taksat, detyrimet tatimore dhe detyrimet e tjera që mund të kërkojnë ose faturohen në Shqipëri, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

4. ZKP-së i jepet një numër identifikimi tatimor (NIPT) dhe ka të drejtën për të hapur dhe përdorur llogari bankare.

5. Pjesëtarët e stafit të TIKa-s, të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, dhe anëtarët e familjes së tyre që do të qëndrojnë në Shqipëri, sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, do të pajisen me viza qëndrimi dhe leje të tjera të nevojshme gjatë kohëzgjatjes së detyrës së tyre. Gjatë hyrjes dhe daljes nga Shqipëria, sendet personale dhe shtëpiake të pjesëtarëve të stafit të TIKa-s, të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, nuk do t'i nënshtrohen asnjë takse, detyrimi doganor dhe tarife tjetër.

Neni 7

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën, me kanale diplomatike, mbi përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

2. Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh nga data e hyrjes në fuqi dhe do të zgjatet automatikisht për periudha vijuese prej 5 (pesë) vitesh, përveç kur njëra nga palët njofton me shkrim palën tjetër, me kanale diplomatike, 6 (gjashtë) muaj para përfundimit të marrëveshjes, mbi qëllimin e saj për të zgjidhur marrëveshjen.

3. Secila prej palëve mund ta zgjidhi këtë marrëveshje në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër, me kanale diplomatike, mbi qëllimin e saj për të zgjidhur marrëveshjen. Në këtë rast, marrëveshja zgjidhet 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

4. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në çdo kohë me miratimin e ndërsjellë të dhënë me shkrim nga palët. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni.

5. Zgjidhja e kësaj marrëveshjeje nuk cenon aktivitetet dhe projektet që janë tashmë në proces ose që janë zbatuar.

6. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje zgjidhen me mirëkuptim përmes negociatave.

7. Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje shfuqizohet “Marrëveshja ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë”, nënshkruar më 12 tetor 2001.

8. Nënshkruar në _____, më _____._____, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast konflikti në interpretimin e kësaj marrëveshjeje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Igli Hasani
MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT
E JASHTME

NË EMËR TË QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË
Mehmet Nuri Ersoy
MINISTËR I KULTURËS DHE TURIZMIT



AGREEMENT

BETWEEN

**THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF
ALBANIA
AND**

THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF TÜRKİYE

**ON DEVELOPMENT COOPERATION AND THE STATUS OF
THE TIKA PROGRAM COORDINATION OFFICE IN ALBANIA**

The Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Türkiye and (to be referred hereafter as “Parties”),

On the basis of friendly relations between the two countries,

For the purpose of developing economic and social cooperation and

Desiring to deepen relations through development cooperation,

Have agreed on the following:

**ARTICLE 1
PURPOSE**

1. The primary objective of this Agreement is to put the legal and institutional framework for development cooperation between the Parties.
2. Under this Agreement, Parties shall cooperate in order to enable the implementation of projects and programs of development cooperation to support the sustainable social and economic development in Albania.



ARTICLE 2 IMPLEMENTION

1. The Turkish Cooperation and Coordination Agency (Hereinafter referred to as “TIKA”) on behalf of the Government of Türkiye and the State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination (Hereinafter referred to as “SASPAC”) on behalf of the Council of Ministers of the Republic of Albania, shall be responsible for the cooperation and implementation of the projects and programs developed under this Agreement.
2. TIKA will be represented in the Republic of Albania by TIKA Program Coordination Office (to be referred hereafter as “PCO”).
3. Progress under this Agreement will be reviewed annually by the Joint Commission (or Joint Committee/Joint Working Group) consisting of officials from TIKA and SASPAC, through meetings to be held alternately in Türkiye and Albania.

ARTICLE 3 FORMS OF COOPERATION

1. The cooperation of the Parties under this Agreement shall be in the form of technical and financial assistance. Technical assistance to Albanian Party shall be carried out by the TIKA in the form of know-how transfer, staff-training, consultation activities and provision of services, supply of equipment materials, introduction of innovative technologies necessary for the successful implementation of projects, programs and activities. Financial assistance to Albanian Party shall be carried out by TIKA in the form of grants to finance supplying of goods, equipment and materials and providing works and services necessary for the successful implementation of projects, programs and activities.
2. The Government of the Republic of Türkiye will implement, through TIKA, concrete projects, programs and activities in Albania under the framework of this Agreement. Projects, programs and activities may be carried out either on a purely bilateral basis or in cooperation with the third parties such as other donors, multilateral organizations, NGO's or public and private institutions
3. Projects and programs developed under this Agreement shall contribute to social and economic development and to be in line with the priorities and needs of the people of Albania. The cooperation, insofar as possible, promotes usage of local resources, provision of local employment opportunities and evaluation of human resources.
4. Within the scope of the cooperation envisaged in this agreement, the coordination of projects supported by TIKA will be provided / carried out in cooperation by the parties through specific agreements.



ARTICLE 4

FIELDS OF COOPERATION

The Parties cooperate in below mentioned fields;

1. Agriculture, animal husbandry, fisheries and forestry
2. Agro-industry and food safety
3. Water and sanitation, irrigation
4. Rural development and poverty reduction
5. Promoting quality, reliable, sustainable and inclusive industries and infrastructure
6. Social and economic inclusion of women and disadvantaged groups
7. Education and scientific research
8. Good health and well-being
9. Development of institutional capacities, reinforcement of local and central administrative structure
10. Conservation and restoration of cultural heritage and cultural cooperation
11. Environmental protection
12. Tourism
13. Maritime cooperation
14. Promotion of innovation and technology

ARTICLE 5

TIKA PROGRAM COORDINATION OFFICE

1. TIKA shall establish a PCO in Albania. The PCO will be located in Tirana and consecutive offices may be settled in other locations in case of need.
2. In accordance with the parties' relevant legislation, the PCO will possess legal personality in Albania. In accordance with the Turkish, Albanian and relevant international legislations, the PCO shall have legal capacity to:
Conclude contracts,
Rent, acquire and dispose of movable and immovable property,
Employ local staff in the PCO,
Open bank accounts and make transactions in cash assets,
Be a party to legal proceedings.
4. Sufficient number of staff (Program Coordinators, Assistant Coordinators, Project Managers, Trainers, Advisors, Experts, Assistants, Researchers, Technical Staff and Support Personnel) shall be appointed to the PCO by TIKA Headquarter.
5. Albanian authorities shall issue entry visas to the temporarily assigned experts in Albania by TIKA for the implementation of the projects, programs and other activities and also to the official invitees of the TIKA PCO free of charge.



ARTICLE 6 PRIVILEGES AND IMMUNITIES

In order to secure full implementation of the projects to be conducted within this Agreement, the Council of Ministers of Republic of Albania shall guarantee the following measures in accordance with its existing laws, rules, regulations and internal procedures.

1. TIKA staff appointed to TIKA Program Coordination Office, who are holders of diplomatic, service and special passports shall benefit from the rights, privileges and immunities provided to the diplomatic agents in Albania, in accordance with the Vienna Convention on Diplomatic Relations of 1961.
2. The premises of the PCO, their furnishings and other property thereon and the means of transport at the service of the PCO shall benefit from the privileges and immunities provided to foreign diplomatic missions in the Vienna Convention on Diplomatic Relations of 1961.
3. All kinds of properties, movable or immovable, imported or purchased in the country, related to TIKA programs, projects and activities in Albania as well as grant funds financing services and/or works, shall be exempt from any taxes, levies, duties and other tax obligations that could be requested or charged in Albania, based on the legal framework in force
4. PCO shall be granted a tax ID number and have capacity to open and operate bank accounts
5. TIKA staff prescribed under the first paragraph of this Article and the members of their family forming part of their household who will stay in Albania under the terms of this Agreement, shall be provided with resident visas and other needed permits during the terms of their duty. Entry and departure of personal effects and household goods of TIKA staff prescribed under the first paragraph of this Article and of their family will be allowed free of all taxes, customs duties and other charges in periods of arrival in and departure from Albania.

ARTICLE 7 LAST PROVISIONS

1. This Agreement shall enter into force on the date of the receipt of the last written notification by which the Parties notify each other through diplomatic channels, of the completion of their internal legal procedures required for its entry into force.
2. This Agreement shall remain in force for a period of five (5) years from the date of its entry into force and shall be extended automatically for successive periods of five (5) years, unless one of the Parties notifies the other in writing through diplomatic



channels of its intention to terminate the Agreement six (6) months prior to its expiration.

3. Each party may terminate this Agreement at any time by giving to the other Party a written notification to that effect through diplomatic channels. In this case, the Agreement shall be terminated six (6) months after the date of the receipt of the notification.
4. This Agreement may be amended by mutual written consent of the Parties at any time. The amendments shall enter into force in accordance with the same legal procedure prescribed under the first paragraph of this Article.
5. The termination of this Agreement shall not affect the activities and projects already in progress or executed.
6. Disputes that may occur in the implementation of this Agreement shall be settled amicably through negotiations.
7. Upon entry into force of this Agreement, the “Agreement Between the Government of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Türkiye”, signed on 12 October 2001, shall be abrogated.
8. Done in _____ on __/__/____ in two original copies, each made in Albanian, Turkish and English languages, all texts being equally authentic. In the event of any divergence of interpretation, the English text shall prevail.

ON BEHALF OF
THE COUNCIL OF MINISTERS OF
THE REPUBLIC OF ALBANIA



IGLI HASANI

MINISTER FOR EUROPE AND
FOREIGN AFFAIRS

ON BEHALF OF
THE GOVERNMENT OF
THE REPUBLIC OF TÜRKİYE



MEHMET NURİ ERSOY
MINISTER OF CULTURE AND
TOURISM



DEKRET
Nr. 232, datë 25.6.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 57/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për bashkëpunimin për zhvillim dhe statusin e Zyrës së Koordinimit të Programeve të TIKA-s në Shqipëri”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM
Nr. 421, datë 26.6.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS SË
PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE
SHITESAVE TË TJERA MBI PAGË TË
ZËVENDËSMINISTRIT,
FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE,
PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT,
NËPUNËSVE CIVILË DHE
NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE
TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me

ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të shkronjës “d”, të pikës 1, të kreut I, shtohen emërtesat, si më poshtë vijon:

a) Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror;

b) Administrata (specialist) në qendrat burimore dhe shkollat me status të veçantë.

2. Lidhjet nr. 1, nr. 2, nr. 12, nr. 12/1, nr. 12/3, nr. 12/5 e nr. 12/6 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Pika 11/2, e kreut III, dhe lidhja 12/2 shfuqizohen.

4. Në lidhjen nr. 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Në ministrinë përgjegjëse për financat:

a) në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet:

i. “drejtor i përgjithshëm” në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet rregullatore dhe përputhshmërinë dhe në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin;

ii. “drejtor drejtorie” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.



b) në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj për nëpunësin në pozicionet:

i. “përgjegjës sektori” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. “përgjegjës sektori” në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.

c) në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet:

i. “koordinator” dhe “specialist” në njësitë përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e buxhetit qendror e vendor të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit;

ii. “specialist” në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e programimit makroekonomik dhe fiskal, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për borxhin, në drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për politikën tatimore dhe në drejtorinë përgjegjëse për programimin, standardizimin dhe harmonizimin e kuadrit rregullator.

ç) në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në njësitë e tjera organizative të përmbajtjes.”

b) Pas pikës 26 shtohet pika 27, me këtë përmbajtje:

“27. Në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për nëpunësit në pozicionet “drejtor i përgjithshëm”, “drejtor drejtorie”, “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në:

a) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për pronën shtetërore;

b) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e nxitjes së biznesit dhe të tregtisë;

c) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për analizat ekonomike;

ç) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për çështjet e punësimit;

d) drejtorinë e përgjithshme përgjegjëse për inovacionin;

dh) drejtorinë përgjegjëse për çështjet e strehimit.”

5. Në lidhjen nr. 4:

a) në shkronjën “b”, pas fjalëve “përgjegjës sektori” shtohet “inspektor”;

b) pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit – “specialist, vullat zyrtare”, përgjegjës për prodhimin fizik të vulave zyrtare për institucionet publike.”.

6. Në lidhjen nr. 8, pas fjalëve “Zëdhënës i ministrit.” shtohen “Koordinator në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.”.

7. Në lidhjen nr. 11, shtohet rreshti, me këtë përmbajtje:

Specialist me funksione administrative në qendrat burimore dhe shkollat me status të veçantë.	IV-4	1, ose 2, ose 3
---	------	-----------------

II. Ngarkohen:

1. Departamenti i Administratës Publike për mbështetjen dhe sqarimin ndaj institucioneve, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, për zbatimin e klasave të pagave deri në momentin e miratimit të strukturave dhe organikave të reja;

2. Institucionet e administratës publike, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, të propozojnë deri më 20 korrik 2024, sipas legjislacionit në fuqi, ndryshimet në strukturat dhe në organikat ekzistuese të degëve territoriale për përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave, të përcaktuara në këtë vendim.

III. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë, si më poshtë vijon:

1. Për përcaktimet e pikave 1, shkronja “b”, 4, 6 dhe 7, të kreut I, të këtij vendimi, nga data e emërimit/transferimit të nëpunësve në detyrë dhe për vitin 2024 përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për këtë vit;

2. Për të gjitha përcaktimet e tjera, nga data 1 korrik 2024 dhe për vitin 2024, përballohen nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Lidhja nr. 1

Kategoritë e klasat e pozicioneve të punës, si dhe vlerat mujore të shtesave të pozicioneve të nëpunësve civilë dhe nëpunësve të institucioneve të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi, me përjashtim të punonjësve të përcaktuar në pikën 2, të kreut II

Kategoria	Klasa e pagës (pozicioneve të punës për secilën kategori)	Elementet e pagës bruto mujore, përjashtuar shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) dhe për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, që jepen rast pas rasti sipas përcaktimit në këtë vendim		
		Paga për pozicionin (lek në muaj)	Shtesa e nivelit të kualifikimit	Shtesa për vjetërsi (sipas mënyrës së llogaritjes së përcaktuar në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut II)
1	2	3	4	5
E lartë drejtuese	I	I-1	235 000	1
		I-2	217 000	1
		I-3	205 000	1
		I-4	180 000	1
		I-5	170 000	1
E mesme drejtuese	II	II-1	155 000	1
		II-2	141 000	1
E ulët drejtuese	III	III-1	115 000	1
		III-2	105 000	1
		III-3	98 000	1
Ekzekutive	IV	IV-1	90 000	1 ose 2
		IV-2	80 000	1 ose 2, ose 3
		IV-3	70 000	1 ose 2, ose 3
		IV-4	60 000	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 2

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (lek/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK (Master i shkencave. Master i arteve. Master Profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	14 000
2	Niveli 7 i KSHK-së (Master profesional. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	12 000
3	Niveli 6 i KSHK-së (Bachelor. Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë.)	10 000



Lidhja nr. 12

Klasat e pagave të nëpunësve në pozicionet “specialist” deri në “titullar institucioni”, në degët territoriale të institucioneve të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, të punonjësve që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, administratave rajonale të zonave të mbrojtura, të komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë prefektit të Qarkut, të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef sektori”, në drejtoritë e policisë në qarqe, në komisariate dhe reparte autonome, si dhe të punonjësve civilë në qendrat e rekrutimit dhe mobilizimit dhe komandat e mbështetjes rajonale, të sistemit të Forcave të Armatosura

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Titullar i institucionit rajonal. Drejtor i drejtorive të ujitjes dhe kullimit. Përgjegjës i degës së thesarit në qendër qarku. Drejtor i drejtorive të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe.	III-1	1
Titullar i institucionit vendor. Drejtor i degës territoriale të Shërbimit të Provës. Përgjegjës sektori në degën e thesarit Tiranë. Përgjegjës të degëve të tjera vendore të thesarit. Drejtor drejtorie në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Përgjegjës sektori në institucionet rajonale. Përgjegjës sektori në drejtoritë e administrimit dhe të mbrojtjes së tokës në qarqe. Përgjegjës i zyrës vendore të punësimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Përgjegjës i zyrës rajonale. Përgjegjës sektori në drejtoritë e ujitjes dhe kullimit.	III-2	1
Përgjegjës sektori në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar). Përgjegjës i gjendjes civile pranë prefektit. Përgjegjës sektori në institucionet/zyrat vendore.	III-3	1
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në njësitë administrative (si funksion i deleguar). Përgjegjës i sektorit të financës dhe administrimit në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional.	IV-1	1
Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës. Specialist në njësitë teknike të përmbytjes në drejtoritë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Specialist në degët e thesarit. Specialist në degët rajonale të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit. Specialist në drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar. Inspektorë të sistemit të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë. Specialist në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit.	IV-2	1 ose 2, ose 3
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki (si funksion i deleguar). Specialist në drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit. Specialist i gjendjes civile pranë prefektit. Specialist në institucionet rajonale. Specialist në zyrat vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Specialist në Ofruesin e Arsimit dhe Formimit Profesional. Specialist në zyrat vendore të arsimit parauniversitar. Restaurator arti. Arkitekt. Inspektor. Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës.	IV-3	1 ose 2, ose 3
Specialist në institucionet e tjera vendore. Specialist i zyrës së gjendjes civile në njësitë administrative (si funksion i deleguar). Restaurator. Instruktor. Piktor. Kontrollor pune. Specialist në degën territoriale të Shërbimit të Provës.	IV-4	1 ose 2, ose 3



Lidhja nr. 12/1

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar institucioni” në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit.	II-2	1	10 000
Zëvendëstitullar i institucionit.	III-1	1	8 000
Përgjegjës sektori të shërbimit social.	III-2	1	6 000
Përgjegjës sektori.	III-3	1	5 000
Specialist i sektorit të shërbimit social/psikolog/punonjës social.	IV-1	1 ose 2	5 000
Specialist.	IV-3	1 ose 2, ose 3	4 000

Lidhja nr. 12/3

Klasat e pagave të nëpunësve civilë në pozicionet mbështetëse “specialist”, “shef seksioni” dhe “përgjegjës/shef sektori” në drejtoritë e policisë në qarqe, komisarate dhe reparte autonome

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës
Përgjegjës/shef sektori në drejtoritë e policisë së qarkut.	III-2	1
Shef seksioni në drejtoritë e policisë së qarkut, komisarate, apo reparte autonome.	III-3	1
Specialist.	IV-3	1 ose 2, ose 3
	IV-4	1 ose 2, ose 3

Lidhja nr. 12/5

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i degës”, në degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i institucionit rajonal.	III-1	1	18 500
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbajtjes.	III-2	1	18 500
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës.	III-3	1	0
Inspektor.	IV-3	1 ose 2, ose 3	18 500
Specialist në sektorët mbështetës.	IV-3	1 ose 2, ose 3	0

Lidhja nr. 12/6

Klasat e pagave dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçantë pune) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “specialist” deri në “titullar i zyrës përmbarimore vendore”, në zyrat përmbarimore vendore të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror

Pozicioni	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Shtesa për kushte pune (natyrë të veçantë pune) (lek/muaj)
Titullar i zyrës.	II-1	1	15 000
Përgjegjës sektori.	III-3	1	0
Specialist.	IV-2	1 ose 2, ose 3	0



VENDIM

Nr. 422, datë 26.6.2024

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 326, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE
PUNONJËSVE TË TJERË TË
SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË
DISA INSTITUCIONE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 12, e vendimit nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“12. Për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse, konkretisht:

a) punonjësve të sektorit të teknikës së shtypshkrimit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

b) punonjësve shpëtues të sektorit të emergjencave dhe shpëtimit të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

c) punonjësve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

ç) punonjësve në pozicionin “shofer-mekanik” në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

d) punonjësve, të cilët punojnë në shërbimet e shëndetit mendor e që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët me probleme të

shëndetit mendor, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj. Ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë përcakton vendet e punës, që përfitojnë këtë shtesë me miratimin e strukturave të institucioneve shëndetësore përkatëse;

dh) punonjësve, të cilët punojnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj. Kjo shtesë aplikohet pas miratimit të strukturave të institucioneve të ekzekutimit të veprave penale përkatëse, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë;

e) punonjësve në pozicionin “shofer” në urgjencën e spitaleve, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

ë) punonjësve në pozicionin “rojë mjedisore” në administratat e zonave të mbrojtura, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj;

f) punonjësve në pozicionet “përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)”, “kuzhinier”, “administrues hoteli” dhe “ndihmëskuzhinier” në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj;

g) punonjësve në pozicionet “laborant” dhe “teknik i mesëm aparaturash” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 19 000 (nëntëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj;

gj) punonjësve në pozicionin “punëtor mirëmbajtjeje (krematoriumi)” në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

h) punonjësve në pozicionet “mjeshtër ndriçimi/fonie” dhe “mjeshtër rrobaqepës” në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj;

i) punonjësve në pozicionet “mjeshtër skene”, “mjeshtër parukier-grimier”, “mjeshtër garderobier”, “mjeshtër marangoz”, “mjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër grimier”, “mjeshtër dekor”, “mjeshtër rekuizite” “ndihmësmjeshtër rrobaqepës”, “ndihmësmjeshtër rekuizitier”, “ndihmësmjeshtër dekorator”, “ndihmësmjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër marangoz”, “ndihmësmjeshtër i mekanikës skenike”, “ndihmësmjeshtër parukier-grimier” dhe “ndihmësmjeshtër gardërobier”, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë)



lekë në muaj;

j) punonjësve në pozicionet “mjeshtër ndriçimi/fonie” në Teatrin Kombëtar, në masën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë në muaj;

k) punonjësve në pozicionet “mjeshtër skene”, “mjeshtër parukier-grimier”, “mjeshtër garderobier”, “mjeshtër marangoz”, “mjeshtër këpucar”, “mjeshtër dekor”, “mjeshtër rekuizite” “ndihmësmjeshtër grimier”, “ndihmësmjeshtër ndriçim/fonie”, “ndihmësmjeshtër rekuizitier”, “ndihmësmjeshtër dekorator”, “ndihmësmjeshtër këpucar”, “ndihmësmjeshtër marangozerie”, “ndihmësmjeshtër i mekanikës skenike”, në Teatrin Kombëtar, në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë në muaj;

l) punonjësit në pozicionin “magaznier”, në Kryeministri në masën 23 000 (njëzet e tre mijë) lekë në muaj;

ll) punonjësit e tjerë mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe në

institucionet e pavarura në nivel qendror, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj;

m) punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, që nuk përfshihen në shkronjat “a” deri në “ll”, të kësaj pike, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar dhe fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 80 lekë